



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Municipal Istog  
Municipal Istog

## Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.10/22

Datë: 13.01.2022

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog duke u bazuar në nenin 67 dhe 68 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitet në Republikën e Kosovës, UA-MPMS, Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik ,UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe UA-MASHT, Nr.08/2021 për Ndryshim dhe Plotësim të UA-MASHT, Nr.05/2021 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm , shpall këtë:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës/e dhe punëtor teknik

#### SHFMU "Hysni Zajmi" Vrellë

1. Një mësimdhënës/e për Gjeografi, normë jo e plotë, kohëzgjatja e kontratës deri me 31.08.2022.
2. Një punëtor/e ndihmës/e (pastrues/e) vend i lirë.

#### SHFMU "Trepça" Banjë

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë **për nxënësit e komunitetit boshnjak.**
2. Një mësimdhënës/e për Fizikë zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### SHFMU "Ndre Mjeda" Rakosh

1. Një mësimdhënës/e për Matematikë vendi i lirë i punës nga data 05.02.2022 në dy shkolla normë jo e plotë.

#### SHFMU "Mehmet Akifi" Shushicë

1. Një mësimdhënës/e për mësim klasor,(paralelja e ndarë Shushicë e Ultë) vendi i lirë i punës nga data 17.03.2022.

#### SHFMU "Fan.S.Noli" në Llukac i Begut

1. Një mësimdhënës/e për nivelin 1-5, zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

#### Gjimnazi "Haxhi Zeka" në Istog

1. Një mësimdhënës/e për Matematikë zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

## IP "Gëzimi Ynë" në Istog

- 1 Një punëtor/e (Rrobalarëse) vend i lirë i punës.

## IP "Shpresa Jonë" në Banjë

1. Një edukatore për grup moshat 5-6 zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.
- **Për vendin e punës punëtor/e ndihmës/e është obligative që kandidatët ta kenë të përfunduar shkollën e mesme të lartë.**

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes.
- Kopja e diplomës e vërtetuar ose certifikata në vend të diplomës jo më e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t'i kenë diplomat e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

**Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:**

**Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, MASHTI, Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.**

**Konkursi mbetet i hapur për aplikim nga data 13.01.2022 deri 27.01.2022.**

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhes dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjtën zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili dorëzohet pas afatit nuk do të shqyrtohet. Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi, kurse intervistës do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët – kandidatet, të cilët- të cilat arrijnë të kenë me shumë se 50 për qind të kalueshmërisë së testit me shkrim.



Drejtori i DKA-së me autorizim  
Valentina Bytyci